2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shërbimi i pastrimit të zyrave, koridoreve, sallave, koridoreve, banjove, vetratave të brendshme e të jashtme, dyerve dhe shkallëve të të gjitha mjediseve të brendshme të të gjitha zyrave të ALBCONTROL SHA (përfshirë dhe "Marubi Lounge"), do të kryhet përditë nga personeli i shërbimit të kontraktorit të specifikuar si më poshtë vijon:

Shërbimi i pastrimit do të kryhet në ndërtesat si më poshtë:

1. "Marubi Lounge"

Në këto mjedise shërbimi i pastrimit do të kryhet për 7 (shtatë) ditë të javës me sistem 2 (dy) turne.

Kjo është një ndërtesë me sipërfaqe si më poshtë:

	<i>Frekuenca</i>
• Pastrimi dysHEME e zyra : 450 m2.	ditore
• Pastrimi i tualeteve : 44.4 m2 10 tualete (7 banjo; 3 para banjo)	ditore
• Sipërfaqe druri (mure e dyer): 315 m2.	javore
• Fasada e brendshme/Totem/Light Box: 160 m2	javore
• Fasada e jashtme/Totem/Light Box: 160 m2	mujore
• Shërbim Mirëmbajtje tualetesh :44.4 m2 10 tualete (7 banjo; 3 para banjo)	grafiku priodik
• Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete : 494,4 m2 (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike,solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti,qese plastike për mbeturina,	ditore

kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjenike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike)

- Monitorim e shërbime D.D.D: 450 m2
(Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19) mujore

2. Godina e Administratës

Në këto zyra shërbimi i pastrimit do të kryhet për 5 (pesë) ditë të javës me 1 turn. Kjo është një ndërtesë me 3 (tre) kate (kati përdhe, kati I dhe kati II) me sipërfaqet si më poshtë:

Frekuenca

- Pastrimi dysHEME e zyra : 2,398 m2 ditore
- Shkallët: 70 m2 ditore
- Pastrimi i tualeteve : 36 m2 ditore
14 tualete (10 banjo, 4 para banjo)
- Fasada e brendshme/Totem/Light Box: 1,747 m2 javore
- Fasada e jashtme/Totem/Light Box: 1,060 m2 mujore
- Shërbime Mirëmbajtje tualetesh: 36 m2 grafiku periodik
(14 tualete :10 banjo, 4 para banjo)
- Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete : 2,434 m2 ditore
(solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjenike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike)
- Monitorim e shërbime D.D.D. : 5,500 m2 Mujore
(Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19)

3. Godina e Akademisë

Në këto zyra shërbimi i pastrimit do të kryhet për 5 (pesë) ditë të javës me 1 turn. Kjo është një ndërtesë me sipërfaqet si më poshtë:

Frekuenca

- Pastrimi dysHEME e zyra : 771 m2 ditore
- Shkallët: 15 m2 ditore
- Pastrimi i tualeteve : 72 m2 ditore
(12 tualete: 8 banjo, 4 para banjo)
- Shërbime Mirëmbajtje tualetesh: 72 m2 grafiku periodik

(12 tualete: 8 banjo, 4 para banjo)	
• Fasada e brendshme/Totem/Light Box: 490 m2	javore
• Fasada e jashtme/Totem/Light Box: 340 m2	mujore
• Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete : 843 m2 (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike,solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti,qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh,letër higjenike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike)	ditore
• Monitorim e shërbime D.D.D. :771 m2 (Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinsektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19)	Mujore

4. Godina ACC dhe Kulla e Re

Në këto zyra shërbimi i pastrimit do të kryhet për 7 (shtatë) ditë të javës me sistem 2 (dy) turnesh. Kjo është një ndërtesë e ndarë si më poshtë:

Frekuenca

• Pastrimi dysHEME e zyra : 2,891 m2	ditore
• Shkallët: 110 m2	ditore
• Mokat: 450 m2	ditore
• Pastrimi I tualeteve : 220 m2 (24 tualete: 16 banjo, 8 para banjo)	ditore
• Shërbime Mirëmbajtje tualetesh: 220 m2 periodik (24 tualete: 16 banjo, 8 para banjo)	grafiku
• Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete : 3,111 m2 (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike,solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti,qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh,letër higjenike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike)	ditore
• Fasada e brendshme/Totem/Light Box: 1,423 m2	javore
• Fasada e jashtme/Totem/Light Box: 970 m2	mujore
• Monitorim e shërbime D.D.D. :4,000 m2 (Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinsektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19)	mujore

5. Zyrat METEO

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 6 (gjashtë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turni. Kjo është një ndërtesë me sipërfaqet si më poshtë:

	<i>Frekuenca</i>
• Pastrimi dysHEME e zyra : 47 m ²	ditore
• Pastrimi i tualeteve: 7.3 m ² (1 tualet)	ditore
• Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete : 54.3 m ² (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjienike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike.	ditore
• Shërbime Mirëmbajtje tualetesh :7.3 m ² (1 tualet)	grafiku periodik mujore
• Monitorim e shërbime D.D.D. :47 m ² (Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19)	

6. **Zyrat e Brifingut**

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 6 (gjashtë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turni. Kjo është një ndërtesë e ndarë si më poshtë:

	<i>Frekuenca</i>
• Pastrimi dysHEME e zyra : 12 m ² ;	ditore
• Pastrimi i tualeteve: 7.3 m ² (1 tualet)	ditore
• Shërbime Mirëmbajtje tualetesh :7.3 m ² (1 tualet)	grafiku periodik ditore
• Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete :19.3 m ² (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjienike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, açe, doreza plastike)	
• Monitorim e shërbime D.D.D. :12 m ² (Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19)	mujore

7. **Magazina/ pranë Administraës**

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 5 (pesë) ditë të javës me sistem prej 1 (një) turni. Kjo është një ndërtesë e ndarë si më poshtë:

	<i>Frekuenca</i>
• Pastrimi dysHEME e zyra : 400 m ²	ditore

-
- | | |
|---|--------|
| <ul style="list-style-type: none"> • Materiale pastrimi për dysHEME, zyra :400 m²
(solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh) | ditore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Monitorim e shërbime D.D.D. :400 m²
(Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19) | mujore |

8. Lokali / pranë Godinës së ACC dhe Kulla e Re

Në këtë godinë shërbimi i pastrimit do të kryhet 7 (shtatë) ditë të javës me sistem prej 2 (dy) turne. Kjo është një ndërtesë e ndarë si më poshtë:

- | | <i>Frekuenca</i> |
|--|-------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> • Pastrimi dysHEME e zyra: 305 m²; | ditore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Pastrimi i tualeteve: 13 m²
3 tualete (2 banjo 1 para banjo) | ditore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Fasada e jashtme/Totem/Light Box: 186 m² | mujore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Fasada e brendshme:186 m² | javore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Shërbime mirëmbajtje tualetesh: 13 m²
3 tualete (2 banjo 1 para banjo) | grafiku periodik |
| <ul style="list-style-type: none"> • Materiale pastrimi për dysHEME, zyra e tualete :318 m²
(solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjienike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje duarsh, aqe, doreza plastike) | ditore |
| <ul style="list-style-type: none"> • Monitorim e shërbime D.D.D. :305 m²
(Shërbimi i Mirëmbajtjes për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme, dezinfektimin për pandeminë COVID - 19) | mujore |

Grafiku i shërbimi i pastrimit për të gjitha mjediset e ALBCONTROL SHA konsiston në:

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit	Sipërfaqe ne m ²
1	Pastrimi i tualeteve dhe dyshemeve industriale, rezinë, me pllaka, parketi dhe moketi të të gjitha ambienteve	Ditore	8319
2	Materiale pastrimi për dysheme, zyra e tualete (furnizim me solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, etj)	Ditore	7179.6
3	Fasada e brendshme/Totem/Ligh box	Javore	4321
4	Fasada e jashtme/Totem/Light Box	Mujore	2716
5	Monitorim e shërbime D.D.D dhe dezinfektimin për pandeminë COVID - 19	Mujore	Për të gjitha ambjentet e shoqërisë
6	Shërbim Mirëmbajtje tualetesh	Periodike	400

➤ *Shërbime me frekuencë ditore*

- Pastrimi i dyshemeve, industriale, rezinë, me pllaka, parketi dhe moketi të të gjitha ambienteve.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapëve, raftëve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh). Furnizimi i tyre rregullisht me: letër higjienike, letër për fshirjen e duarve, sapun të lëngshëm.
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i ashensorëve.
- Pastrimi i derve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.).
- Fshirje me fshesë (dore) minimumi një herë në ditë.
- Larje me solucion dhe lucidim për dyshemenë, minimumi një herë në ditë (uji që do të përdoret për larje, të pregatitet me solucion larës pllakash dhe lucidues konform normave CE).
- Fshirje me fshesë me korent e sipërfaqeve me moket, një herë në ditë.
- Materiale pastrimi për dysheme, zyra e tualete (solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, letër higjienike, lënde larëse për larje duarsh, letra për fshirje
- Çdo shërbim tjetër i nevojshëm higjeno-sanitar.

- *Shërbime me frekuencë periodike.*
- Pastrimi/larja me solucion larës i vetratave të jashtme me xham struktural *(një herë në muaj)*
- Pastrimi i xhamave nga brenda, vetratave të brendshme, të dyerve të bëhet me solucion komform normave CE *(një herë në javë)*
- Shërbim me Dezinfektim, dezinfektim, deratizim *(një herë në muaj sipas grafikut)*
- Pastrim i sipërfaqeve të drurit. *(një herë në javë)*
- Çdo shërbim tjetër i nevojshëm higjeno-sanitar.
- Shërbime mirëmbajtje tualetesh *(periodikisht)*

➤ **Punonjësit e Shërbimit:**

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme kontraktori duhet të ketë punonjësit e nevojshëm, për të dy turnet e shërbimit (turnin e parë dhe për turnin e dytë) për realizimin me sukses të kontratës. Krahas punonjësve të pastrimit, Kontraktuesi duhet të sigurojë edhe 1 (një) mjek ndërmarrjeje të punësuar me kohe të plote. Punonjësit e pastrimit, gjatë kohës së punës duhet të jenë të veshura me uniformën e Kontraktuesit dhe e ALBCONTROL SHA, e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt. Gjithashtu kontraktuesi duhet të disponojë një kamion me kosh për evadimin e mbeturinave për në pikën e grumbullimit të mbetjeve, si dhe të ndjek procesin e riciklimit të mbetjeve (kjo kërkesë bëhet për shkak se Albcontrol sha është kompani e certifikuar ISO 14001:2015)

➤ **Oraret e kryerjes së shërbimit:**

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme do të kryhet nga dita e Hënë në të Diel, në 2 turne, me oraret si më poshtë:

- a- Turni I: 07:00 – 15:00
- b- Turni II: 15:00 – 21:00

Punonjëset e të dyja turneve, duhet të fokusohen në pastërtinë e korridoreve dhe ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve (pastrimi i dyshemesë, zëvendësimi i qeseve të koshave të mbeturinave, letrave të duarve, letrave higjienike) etj.

Punonjëset e turnit të parë duhet të përqendrohen në mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, korridoreve, tualeteve, ashensorëve, pastrimin e hyrjeve, shkallave, magazinave, Arkivat, Sallat e Mbledhjeve dhe të Konferencave etj. Kontrollimi i pastërtisë së tualeteve duhet të bëhet periodikisht (të paktën çdo 60 minuta). Punonjëset e turnit të dytë duhet të bëjnë pastrime me themel duke filluar me pastrimin e tualeteve dhe më pas me larjen e dyshemesë së korridoreve, pastrimin e ashensorëve, pastrimin e tavolinave të punës dhe pajisjeve informatike mbi to, karrigeve, zyra dhe mobilie brenda tyre, dollapëve, rafteve dhe mobileje të tjera, pastrimin e moketeve, pastrimin e dyerve etj.

➤ ***Materialet e pastrimit:***

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambjenteve të Albcontrol sha, nga Kontraktori duhet të vihen në dispozicion materiale shumë cilësore, për shkak të vetë cilësisë së lartë të strukturës së brendshme. Ato nuk duhet të jenë gërryes dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjenzues. Kontraktori duhet të vejë në dispozicion (por pa u kufizuar në to) materiale të tilla si: solucion larje pllakash, shtupa pastrimi, kova plastike, solucion larje xhamash, peceta pastrimi, aromatizues ambjenti, qese plastike për mbeturina, kosha mbeturinash, solucion pastrimi mobiljesh, kosha të vegjël për zyra, qese mbeturinash, detergjent për pastrim dyshemeje (i cili duhet të jetë sipas llojit përkatës të dyshemesë), detergjent për pastrim moketi, materialet e konsumit (letër higjienike, letër duarsh, sapun likuid), lecka mikrofibrë për marrjen e pluhurave, shtupa të posacme për tualete, lecka për fshirje në të thatë, solucion për pastrim pajisjesh informatike, solucion për pastrim ashensorësh, etj.

➤ ***Kryerja e shërbimit DDD:***

Kalendar i shërbimeve DDD:

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Monitorim e shërbime D.D.D dhe dezinfektimin për pandeminë COVID - 19	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X

- Për kryerjen e këtyre shërbimeve nevojiten makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit si më poshtë vijon:

-Makineri larese	<i>cope 1</i>
-Kazan plerash teknologjik	<i>cope 8</i>
-Kosha te vegjel mbeturinash	<i>cope 18</i>
-Karoca profesionale per sherbimin e pastrimit	<i>cope 5</i>
-Kamion me kosh	<i>cope 1</i>

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbimi i pastrimit të ambjenteve të Albcontrol sha”,

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Shërbimi i pastrimit të ambjenteve të Albcontrol sha”,**

Detyrat: **Sipas specifikimeve teknike**

Shpërndarja: **Sipas specifikimeve teknike**

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Albcontrol sha**

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për 3 vitet e fundit financiare (2018,2019,2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

2.2.2 Bilancet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 miratuar nga organet perkatese shtetërore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi*

të ardhurat", i ndryshuar.

Duke marre ne konsiderate shërbimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet te paraqese kontrata ku te kete realizuar shërbime te ngjashme, në një vlerë jo më të vogël sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë ne vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar jo me pak se 30 punonjes per tre muajt e fundit nga data e shpalljes se procedures, per ndjekien/zbatimin e kontrates.

a) Listëpagesat perkatese E-Sig të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për tre muajt e fundit.

b) Vërtetim nga tatimet, që ka paguar të gjitha detyrimet dhe sigurimet shoqërore për tre muajt e fundit, të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të pasqyrohet numri i punonjësve për çdo muaj.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa per stafin e nevojshem per kryerjen e shërbimit objekt procedure prokurimi bazohet ne piken 4, te nenit 77, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 4/c, te nenit 41 te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Ky numer punonjeshish konsiderohet minimal per kryerjen e shërbimit, duke patur parasysht te gjithë llojet e shërbimit qe do te realizohen.

2.3.3 Operatorët ekonomikë ne lidhje me ceshtjet e sigurise dhe shendetit ne pune duhet te kete te punësuar me kontrate individuale te punes (një) mjek te shoqërisë, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje një CV te mjekut, Licencën e tij, diplomën dhe kontratën e punës.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e mjekut të nevojshëm bazohet në VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë”, i ndryshuar dhe pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhteme:

- a) Vlerësimi e ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor. (Kategoria C).
- b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, perpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane. (Kategoria C).
- c) Leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për pastrimin e sistemit, gjelberimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucioneve (Leje C).
- d) Licence II.8.B, Licence për Shërbime Nderhyrëse Higjieno-shëndetësore (Dezinfektim, Dezinfektim, Deratizim).

Argumentimi: Kërkesa për licencat e mësipërme lidhet ngushtësisht me kryerjen e shërbimit objekt kontrate dhe bazohet në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/a, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015** ose versioni më i përditësuar ose ekuivalent, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 14001:2015** ose versioni më i përditësuar ose ekuivalent, Sistemi për Menaxhimin e Mjedisit ose ekuivalent e cila duhet të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 45001:2018** ose versioni më i përditësuar ose ekuivalent, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë ose ekuivalent e cila duhet të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se

disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standardi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001 është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomikë ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu domosdoshmëria e kësaj ISO-je si kriter kualifikues, konsiderohet me e rëndësishme pasi në objektin e prokurimit parashikohet larja e fasades së jashtme të godinave.

Standardi i menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001 është kërkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues do të sjellë produktet të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë, që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë në këtë orientim.

Standardi i cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror” dhe duhet të marrë çdo masë të nevojshme për parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarisë së saj, ku për shkak të moscertifikimit të duhur të kontraktoreve, AK mund të pezullojë ose të vonojë veprimtarinë e saj, duke shkaktuar një dëm të madh në trafikun ajror shqiptar, ku është edhe objekti i saj kryesor. Gjithshtu Albcontrol sha është i certifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se disponon (në pronësi ose me qira) të gjitha makineritë dhe pajisjet për ofrimin e shërbimit të pastrimit:

-Makineri larese	cope 1
-Kazan plerash teknologjik	cope 8
-Kosha të vegjël mbeturinash	cope 18
-Karoca profesionale për shërbimin e pastrimit	cope 5
-Kamion me kosh	cope 1

a) Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinë për disponimin e makinerive të shoqëruar me dokumentat e mëposhtme:

- Aktin e pronësisë së mjetit perkates; ose
- Kontraten e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin perkates të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirase të jetë e noterizuar.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qofte në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë pronësie, taksat vjetore si dhe certifikatën e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti nga komuna ose bashkia për vetë ose për të tretet sipas legjislacionit në fuqi (të vlefshme).

b) Për këtë pikë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër dhe do të perdoren vetëm për realizimin e kësaj kontrate shërbimi.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

